



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 141

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “ALEANCA E MAQEDONASVE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN” PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1381 Prot., datë 6.3.2023, me:

- Kërkues:** Partia politike “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, me kryetar z. Vasil Sterjovski
- Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023
- Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia politike “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Vasil Sterjovski, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

Data: 8.3.2023 Nr: 141
Ora:11:00



Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 15.02.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia politike “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, me iniale “AMIE”, me Kryetar z. Vasil Sterjovski rezultoi të regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezultoi se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European” me shkronja nistore “AMIE”, me adresë fshati Pustec, Bashkia Pustec;
- b) Kryetari i partisë është z. Vasil Sterjovski, me adresë Rruga “Thanas Floqi”, Objekti IV, Hyrja nr.2, Kati V, Lagjia nr. 18, Korçë;
- c) Financieri i partisë është z. Taqo Grozdani, me adresë Fshati Shulin, Bashkia Pustec;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Endrit Fetahu, me adresë Rruga “Grigor Heba” Nd.13, K. 4, Ap. 10, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia politike “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga partia politike “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64 pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, me kryetar z. Vasil Sterjovski, me shkronjat nistore “AMIE”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

